



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada – Government*

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve  
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers  
*Thesari i Kosovës - Trezor Kosova - Treasury of Kosovo*

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Thesari i Kosovës - MFPT shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Udhëheqës i Divizionit të Sistemit të Pagave
<b>Klasa e pozitës</b>	Drejtues i Ulët
<b>Koeficienti/Paga</b>	7.35
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	13/09/2023
<b>Afati për aplikim</b>	28/09/2023 - 05/10/2023
<b>Institucioni</b>	Thesari i Kosovës - MFPT
<b>Departamenti</b>	Departamenti Administratës, Teknologjisë Informative dhe Pagave
<b>Divizioni</b>	Divizioni i Pagave
<b>Vendi i punës</b>	Thesari i Kosovës - MFPT
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00012435
<b>Kodi</b>	RPC0005994



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Implementon politikat dhe programet lidhur me procesimi i pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave që caktohen me akte normative të Qeverisë apo Ministrit;
2. Siguron zbatimin e legjislacionit lidhur me procesimin e pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
3. Identifikon dhe planifikon nevojat për hartimin e legjislacionit, politikave dhe programeve lidhur me procesimin e pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
4. Grumbullon, analizon dhe raporton të dhënat për nëpunësit/zyrtaret publik;
5. Përgatitë dhe harton manuale apo udhëzues për zbatimin e politikave dhe legjislacionit përkatës lidhur me procesimi i pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
6. Merrë pjesë në realizimin e publikimeve për përgatitjen e raporteve, analizave dhe hulumtimeve lidhur me procesimin e pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
7. Përgatitë dhe harton raporte për institucionet përkatëse/OB lidhur me procesimin e pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
8. Koordinon aktivitetet që kanë për qëllim përmirësimin e procesin të regjistrimit, aplikimit dhe përfitimit për te gjithë zyrtaret/nëpunësit publik lidhur me procesimin e pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
9. Koordinon aktivitetet me departamentin përkatës të TI dhe institucionet qeveritare për TI lidhur me sistemet elektronike përmes të cilit mundësohet implementimi i procesimit te pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
10. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me organizata buxhetore lidhur me procesimi i pagave te sektorit publik si dhe ndryshimet ne kalkulimin e pagave;
11. Kujdeset dhe monitoron procesin deri në finalizimin e ekzekutimit te pagave për te gjithë nëpunësit–zyrtaret e sektorit publik;
12. Bashkëpunon dhe koordinohet me Divizionet përkatëse te Thesarit, Bankat apo institucionet tjera përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal për ekzekutimin, monitorimin dhe kontrollimin e ekzekutimit te pagave për te gjithë nëpunësit/zyrtaret e sektorit publik te cilët pranojnë paga nga Buxheti i Republikës se Kosovës.

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve te fundit të vlerësimit.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimitimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në ekonomi, financa dhe kontabilitet
- Kualifikime të posaçme formale;
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e ekonomisë për plotësimin e pozitës së lirë të punës.
- Dokument që dëshmon se nuk jeni në hetime dhe
- Dokument që dëshmon se nuk keni qene i dënuar.



## 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar;
- Njohuri të gjuhës Angleze, në të folur dhe të shkruar e obligueshme;
- Aftësi për të krijuar marrëdhënie pune të shkëlqyeshme ndër-personale, dhe për të menaxhuar;
- Aftësi që çështjet e ndërlikuara të analizohen dhe përcillen në mënyrë efektive dhe efikase;
- Aftësi të mira për të përcaktuar prioritetin e detyrave të rëndësishme dhe aftësi për të punuar nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Aftësi të avancuara analitike dhe transmetuese;

## 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopja e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore ( diploma jashtë shtetit të jete e nostrifikuar);
- Kopje të dëshmisë së punësimit;
- Kopje të dëshmisë së trajnimeve;
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit;
- Dokument nga burimet njerëzore që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 12/10/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- 19/10/2023, (data e përafërt ) ora 10 :00 kati 10 salla nr. 1002, Thesari i Kosovës / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

- Të ketë njohuri në fushën e Financave Publike, Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;
- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar;
- Njohuri të gjuhës Angleze, në të folur dhe të shkruar e obligueshme;
- Aftësi të avancuara analitike dhe transmetuese;

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

